



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-II.-13-0191-C0001

Paditësja:

D.B., në emër të Xh.B. (i ndjerë), nga Komuna e Podujevës

Kundër:

E paditura

NSH në Prishtinë, të cilën e administron **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “*Agim Ramadani*”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 26 shtator 2019, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- I. Çështja konsiderohet *res iudicata* për faktin se Aktvendimi SCEL-09-0001, i lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës më 24 shkurt 2011 dhe Aktvendimi ASC-11-0035, i lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës më 23 nëntor 2012 janë ende të vlefshme.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 11 korrik 2013 paditësja D.B. nga Komuna e Podujevës në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë Xh.B., ish punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore në Prishtinë, ka parashtruar padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ku kërkon miratimin e kërkesëpadisë dhe të detyrohet e paditura AKP-ja që në emër të kompensimit nga shitja e ndërmarrjes t’ia lejojë të drejtën e 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së.

Më 23 tetor 2018 Agjencia Kosovare e Privatizimit paraqet përgjigjen e saj lidhur me ankesën e parashtruar nga D.B..

Në përgjigjen e vet AKP-ja i referohet nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 dhe thekson se afati i parashtrimit të ankesës në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare ishte 27 mars 2009, ndërsa ankesa është parashtruar pas afatit, respektivisht më 24 qershor 2018.

AKP-ja në përgjigjen e saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që ankesën e parashtruar ta hedhë poshtë si të papranueshme.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).

Më 24 shkurt 2011 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte nxjerrë aktvendimin me nr. SCLE-09-0001, përmes së cilit ankesën C1218 të ankueses D.B. në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë Xh.B., të parashtruar kundër AKP-së, e kishte hedhur poshtë si të papranueshme.

Në arsyetimin e këtij aktvendimi Gjykata thekson se ankesa ishte parashtruar më 4 maj 2010, d.m.th. tre muaj nga dita e skadimit të afatit për parashtrimin e ankesës (afati kohor për parashtrimin e ankesës kishte skaduar më 27 mars 2009).

Më 23 nëntor 2012 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte nxjerrë aktvendimin me nr. ASC-11-0035, përmes së cilit ankesën nën numrin rendor 4 të ankueses D.B. në emër të bashkëshortit të saj të ndjerë Xh.B., të parashtruar kundër AKP-së, e kishte refuzuar si të pabazuar.

Gjyqtarja e Dhomës së Posaçme ka vërejtur se objekti dhe zgjidhja ligjore e kërkuar nga ankuesja në këtë lëndë (C-II.-13-0191-C0001) kundër të njëjtit të paditur janë tërësisht të njëjta për çka është vendosur me Aktvendimet e mëparshme SCLE-09-0001 dhe ASC-11-0035, i cili bëhet *res iudicata* midis palëve.

Neni 391 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (*res iudicata*);

Pasi që kjo çështje ligjore është vendosur me herët përmes një Aktvendim të gjykatës mes palëve të njëjta, Dhoma e Posaçme duke e zbatuar dispozitën e nenit 391, pika d i LPK-së vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për arsyet e lartcekura gjykata nuk është lëshuar fare në merita lidhur me këtë çështje.

Andaj, për arsye të cituar më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksa Gjyqësore

Më 1 maj 2017 ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për unifikimin e taksave gjyqësore. Neni 13 i këtij Udhëzimi përcakton tarifën e taksave gjyqësore për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ndërsa pika 13.2 e këtij neni parasheh që: *'punëtorët lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore për paditë dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve për përfshirje në listën e punëtorëve me të drejta legjitime'*.

Mbi këtë bazë gjykata vendos që parashtruesin e lartpërmendur të ankesës ta lirojë nga pagesa e taksës gjyqësore.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim – Gjyqtare _____